REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 11118-03130-00-2015 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2015-3658 i Vendimit (463)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përberë nga:

Majlinda ANDREA Kryesues
Admir THANZA Anëtar
Artan BROCI Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 04.11.2015, mori në shqyrtim çështjen civile me nr.**11111-01127-00-2015**, që u përket palëve:

PADITËS: **SHOQËRIA "COMES IMPIANT & SOPI" SH.P.K,** *të përfaqësuar në gjykim nga avokatët Sokol Lamaj dhe Pranvera Goxhi me autorizim të administratorit të paditësit datë 26.02.2015.*

I PADITUR: **DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË "TECNIMONT" S.P.A,** *e përfaqësuar në gjykim nga avokat Enyal Shuke sipas prokurës së posaçme të datës 24.02.2015*

OBJEKTI: *Detyrimi i palës së paditur të paguajë faturat e shitjes të palikujduara.*
Detyrimin e palës së paditur të më shpërblejë dëmin e shkaktuar si rrjedhim i mosshlyerjes së shumës së përcaktuar në faturat, si kamata ligjore mbi shumën e faturuar nga data 29.12.2009 deri në pagesën e plotë të faturave.

BAZA LIGJORE: *Nenet 32, 153, 154, 154/a të K.Pr.Civile. Nenet 419-422 445-454; 476-495; 698-639; 640-647 të Kodit Civil. Kontratë porosie datë 25.09.2008 me nr.45000VL03301.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.s'ka datë 25.05.2015, ka vendosur:

"Rrëzimin e kërkesës së palës së paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.
Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Lartë".

Kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankim të veçantë me datë 26.05.2015, pala e paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, e cila kërkon*, ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare* për këto shkaqe:

- *Në kundërshtim me sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit është bërë nga përfaqësuesit e përbashkët e Tecnimont SPA dhe Dega në Shqipëri e Tecnimont, por dhe nëse do të ishte bërë vetëm nga kjo e fundit, si palë ndërgjyqëse ajo kishte të gjitha të drejtat procedurale që i njeh K.Pr.Civile e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me juridiksionin e gjykata shqiptare për gjykimin e çështjes. Çështja e juridiksionit është një çështje e rëndësishme që dhe gjykata kryesisht duhet ta marrë në shqyrtim në çdo fazë të gjykimit të çështjes.*
- *Vendimi i gjykatë është i pabazuar në dispozitat ligjore dhe provat e administruara në gjykim kur arrin në përfundimin se palët nuk kanë rënë dakort mbi organin kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes,* ***në kundërshtim me parashikimet e nenit 64 të Kushteve të Përgjithshme të Nënkontratës Maire Enginering*** *të datës 25.09.2008. Firmosja e kësaj kontrate përbën dhe pranim të të gjithë dokumenteve bashkëlidhur sic përcaktohet në nenin 28 të saj.*
- *Konkluzioni i gjykatës se jemi në rastet e nenit 686/3 të K.Civil është i pabazuar pasi nuk bëhet fjalë për kushte të përgjithshme të veçanta të cilat paditësi nuk i ka parë dhe i ka marrë të mirëqena, por për një pjesë të kontratës të njohur dhe firmosur rregullisht prej tij. Për më tepër palës paditëse nuk i është vendosur asnjë kufizim lidhur me arbitrazhin, kjo e fundit e ka zgjidhur vetë lirisht organin kompetent për zgjidhjen e konfliktit.*
- *Konkluzioni i i gjykatës se Kushtet e Përgjithshme përbëjnë një shtojcë dhe se shtojca nuk ka efekt ligjor, bie ndesh me dispozitat ligjore dhe kushtet faktike referuar rastit konkret pasi palët në liri të plotë kanë përcaktuar formën e kontratës sipas nenit 660 të K.Civil.*
- *Në interpretim të neneve 11 dhe 28 të Kontratës palët kanë pranuar si pjesë të kontratës dhe Kushtet e Përgjithshme të nën sipërmarrjes së Marie Enginering dhe në të tilla rrethana këto kushte nuk mund të interpretohen si shtojcë pa funksion e kontratës, përkundrazi Kushtet e Përgjithshme në këtë rast janë pjesë thelbësore e kontratës.*
- *Marrëveshja e arbitrazhit është në përputhje të plotë me kërkesat e Konventës së Në Your-ut "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit" të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.*
- *I pabazuar në prova dhe në ligj është dhe konkluzioni i gjykatës se çështja objekt hetimi gjyqësor nuk hyjnë në mosmarrëveshjet e përcaktuar në nenin 64.1 të Kontratës, pasi në rastin konkret jemi përpara një mosmarrëveshje lidhur vlefshmërinë dhe interpretimin e dokumenteve kontraktuale midis porositësit dhe nënkontraktuesit sipas nenit 64 të kushteve të përgjithshme të kontratës. Objekt i kërkesë padisë është pagesa e faturave për shërbime të ofruara në bazë të marrëdhënies kontraktore, objekt i shërbimeve për të cilat janë lëshuar faturat tatimore (neni 3-objekt i punës), kohën e kryerjes (neni 5), çmimi total (neni 6), kushtet e faturimit dhe kushtet e pagesës (nenet 8,10), pranimi i punimeve dhe provat e funksionit (neni 13), kushti penal për vonesat (neni 15) etj. Pra është evidente që mosmarrëveshja lidhur me shërbimet e ofruara dhe kryerjen e tyre në përputhje me kushtet teknike, afatet specifike e tj., janë përcaktuar në kontratë.*

- *Edhe sikur të pranojmë që mosmarrëveshja nuk lidhet me interpretimin e kontratës në bazë të nenit 64.1 përsëri gjykata shqiptare nuk do të kishin juridiksion pasi në nenin 64.2 është parashikuar se nëse palët kontraktuale do të kenë parashikuar në kontratë përjashtimin e arbitrazhit, juridiksioni ekskluziv për mosmarrëveshjet që lindin nga kontrata, do të jetë ai i Gjykatës së Romës.*

Pala paditëse ka paraqitur kundër ankim, duke pretenduar mospranimin e ankimit për këto shkaqe:

- *Kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor e ka paraqitur pala e paditur, Shoqëria "Tecnimont" S.p.A dhe jo Dega në Shqipëri e shoqërisë "Tecnimont" S.p.A, e cila ka bërë ankim të veçantë. Shoqëria "Tecnimont" S.p.A ashtu sic thekson dhe vetë pala e paditur në ankim , nuk është më palë e këtij procesi gjyqësor.*
- *Kërkesat si të datës 23.04.2014 ashtu dhe të datës 13.05.2015 për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit janë bërë nga Shoqëria "Tecnimont" S.p.A dhe fakti që i njëjti përfaqësues ligjor i përfaqëson të dy palët nuk ka lidhje me paraqitjen e kërkimeve dhe qëndrimeve të të dy palëve. Vetë pala e paditur Dega në Shqipëri e shoqërisë "Tecnimont" S.p.A, ka pasur të gjithë kohën dhe mundësitë që i njeh ligji të bënte kërkesë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.*
- *Në kundërshtim me sa pretendon pala e paditur se gjykata nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën lidhur me juridiksionin nisur*...dhe nga fakti që kërkuesi, shoqëria "Tecnimont" s.p.a nuk është më palë në proces.., *nuk është i vërtetë pasi gjykata në vendimin e ndërmjetëm të ankimuar jo vetëm ka evidentuar të gjitha pretendimet e ngritura nga palët për juridiksionin, por ka analizuar në detaje pretendimet e ngritura nga pala e paditur "Tecnimont" s.p.a lidhur me bazueshmërinë e tyre në prova e ligj.*
- *Lidhur me pretendimin e palës së paditur se palët ndërgjyqëse kanë përcaktuar me marrëveshje kontraktore organin kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me kontratën objekt gjykimi duke e mbështetur këtë pretendim në nenin 64.1 të dokumentit "Kushtet e përgjithshme të Nënkontratës Maire Enginering" nuk qëndrojnë për arsye se neni 28 "Shtojcat"në paragrafin e 3 vetëm liston dokumentet që i bashkëlidhen kësaj kontrate.*
- *Gjithashtu, pala e paditur pretendon se nënshkrimi i kontratës përbën pranim të të gjitha dokumenteve bashkëlidhur të cituara në nenin 28, për që pala e paditur kërkuese "harron" të nënvijëzojë që ky dokument nuk është nënshkruar nga pala paditëse dhe në kushtet, për sa kohë dokumenti "Kushtet e Përgjithshme" nuk është nënshkruar nga pala paditëse as në faqen e parafundit ku përfshihet neni 64*
  arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se jemi në kushtet e parashikuara në nenin 686 të Kodit Civil është i bazuar në prova e ligj.
- *Faktet e parashtruara hedhin poshtë dhe pretendimin e palës së paditur kërkuese dhe asaj ankimuese se sipas tyre jemi përpara një klauzole arbitrazhi dhe se kjo klauzolë është parashikuar në kontratë dhe nënshkruar nga palët, kur asnjë nga këto kushte të kërkuara nga ligji dhe Konventa e Nju Jorkut nuk ekzistojnë.*
- *Klauzola e arbitrazhit është parashikuar në shtojcë kontratën dhe jo në atë kryesore sic kërkon kjo konventë që klauzola të jetë në "formën e një klauzole arbitrazhi në* ***një kontratë*** *ose në një* ***marrëveshje arbitrazhi të veçantë****" dhe që* ***duhet të jetë nënshkruar nga palët****. Sic rezulton e provuar nuk ekziston asnjë nënshkrim në dokumentin "Kushtet e Përgjithshme" në nenin 64 të të cilit pretendohet së është përcaktuar klauzola e arbitrazhit.*

- *Referuar objektit të kërkesë padisë edhe sikur të ekzistonte marrëveshja e arbitrazhti, kërkimi i palës paditëse ka të bëje me detyrimin e palës së paditur të paguajë faturat e shitjes së palikujduara dhe nuk jemi përpara ndonjë interpretimi të ri të detyrimeve kotraktore, dhe as përpara pavlefshmërisë së kontratës.*
- *Nëse faturat tatimore do të ishin nxjerrë aktualisht, ato në bazë të nenit 16 të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", do të ishin konsideruar titull ekzekutiv, pa qenë nevoja e zhvillimit të këtij procesi gjyqësor dhe në bazë të nenit 72/dh të ligjit 10428/2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private" do të hynin në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare.*
- *Në asnjë nen të kontratës së datës 21.07.2008, ndryshuar me kontratën e datës 25.09.2008 dhe me kontratën e datës 28.10.2010, nuk bëhet asnjë referim, përsa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjes, në dokumentin "Kushtet e përgjithshme të kontratës, apo të ketë ndonjë dispozite që të parashikojë se për çdo gjë që nuk është përcaktua shprehimisht në këtë kontratë palët kontraktore do ti referohen këtij dokumenti, mungesa e të cilit e bën atë pa fuqi juridike.*
- *Pranimi i dokumenteve bashkëlidhur kontratës dhe i dokumentit "Kushtet e përgjithshme të Nënkontratës Maire Enginering", është për ato pjesë që kontrata kryesore i referohet dokumenteve si kushtet e faturimit; kushtet e pagesës; garancia; penalizimet për vonesat etj., duke u bërë në mënyrë specifike dhe dhënë fuqi juridike neneve të veçanta të tij.*
- *Në rrethana kur rezulton se midis palëve nuk ka pasur një përcaktim për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve gjykata me të drejtë i është referuar ligjit 10428/2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private" neneve 71 dhe 80 të tij duke marrë në konsideratë si natyrën e mosmarrëveshjes ashtu dhe palët ndërgjyqëse. Nga ana tjetër dega e personit juridik gëzon personalitet juridik më vete njësoj si shoqëria tregtare dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime ndaj të tretëve.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Admir Thanza; përfaqësuesin e palës së paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, av.Enyal Shuke, i cili përfundimisht kërkoi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të Gjykatave Shqiptare; përfaqësuesit e palës paditëse Shoqëria "Comes Impiant & Sopi" Sh.p.k, avokatët Sokol Lamaj dhe Pranvera Goxhi të cilët përfundimisht kërkuan, lënien në fuqi të vendimit nr.s'ka, datë 25.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, si diskutoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi, Shoqëria "Comes Impiant & Sopi" Sh.p.k, është një shoqëri shqiptare e regjistruar si person juridik që prej datës 21.07.2008, me objekt të veprimtarisë së saj tregtare *ndërtimin e impianteve, montimin e sistemeve elektro-instrumentale etj*, referuar ekstraktit të QKR-së.
2. Nga ana tjetër i padituri Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, është regjistruar si person juridik në QKR që prej datës 02.10.2007 me adresë të ditur në Shqipëri. Shoqëria "TECNIMONT" S.p.a, është bashkuar me përthithje me shoqërinë "Maire Engineering" SpA që me 30 korrik 2008, si rezultat i së cilës ka ndryshuar dhe emërtimi i Degës së shoqërisë në Shqipëri nga Dega e shoqërisë "Maire Engineering" SpA në Dega e shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a dhe ky vendim është regjistruar në QKR më 2 tetor 2008.

3. Ndërmjet palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë firmosur me datë një kontratë me objekt *Prokurim për montazhet e elektro-instrumenteve për centralin me cikël të kombinuar Vlorë, Shqipëri* e ndryshuar me mendimet e datës 25.09.2008 dhe 28.10.2010.
4. Në padinë e themelit paditësi ka pretenduar se në 28 fatura tatimore të lëshuara prej tij për shërbimet e kryera në periudhën 1 gusht 2008-30 nëntor 2009 për të padituri, ai ka likuiduar pjesërisht për sa është pasqyruar në to.
5. Në seancën e datës 23.04.2015, përfaqësuesja e të padituri Shoqëria "TECNIMONT" S.p.a, ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor me pretendimin se:
   Palët janë persona juridikë privatë të rregjistruar në shtete të ndryshme, pra marrëdhënia juridike e krijuar ndërmjet tyre është një marrëdhënie me elementë të huaj. Referuar nenit 37/1 të K.Pr.Civile palët ndërgjyqëse kanë përcaktuar me marrëveshje organin kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që sipas nenit 64.1 të shtojcës "Kushtet e përgjithshme të nënkontratës" do të jetë arbitrazhi italian, duke mospasur gjykata juridiksion për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje.
6. Nga ana tjetër pala paditëse ka prapësuar se ky gjykim nuk ka të bëje as me vlefshmërinë e kontratës dhe as me interpretimin e saj, por me fatura tatimore që përmbajnë detyrimet monetare të lindura nga veprimet tregtare të pranuara dhe nga pala e paditur, jo vetëm duke nënshkruar në secilën faturë por dhe me veprime konkludente duke paguar pjesërisht vlerën e tyre.
7. Sipas palës paditëse, nëse këto fatura tatimore do të ishin nxjerrë sot, ato në bazë të nenit 16 të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" do të ishin titull ekzekutiv, dhe në bazë të nenit 72/dh të ligjit nr.10428, datë 02.06.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare privatë" do të hynin në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare.
8. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** me vendimin nr.s'ka, datë 25.05.2015, ka vendosur:
   Rrëzimin e kërkesës së palës së paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.
   8.1. Gjykata e shkallës së parë në marrjen e këtij vendimi **ka arsyetuar** se: *"...omissis...lidhur me ekzistencën e një marrëveshje midis palëve që mund të lindin midis tyre gjatë zbatimit të kontratës, Gjykata vëren se pretendimi i palës së paditur kërkuese, Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a, se midis palëve ka pasur një marrëveshje të tillë nuk qëndron për këto arsye:*
   ***<u>së pari</u>**, ashtu siç edhe pranon vetë pala e paditur kërkuese, përcaktimi i kësaj marrëveshje është bërë në një shtojcë të kontratës, në dokumentin me titull "Kushte të përgjithshme" neni 64 i tij. Juridiksioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis palëve është një ndër kushtet kryesore të një kontrate dhe duhet të përcaktohet në kontratën kryesore që lidhet midis palëve e nuk mund të rregullohet e të përcaktohet në një dokument dytësor apo shtojcë të një kontrate.*
   ***<u>së dyti</u>**, ashtu siç përcakton dhe neni 686/3 i Kodit Civil, nuk janë të vlefshme kushtet që kanë të bëjnë me arbitrazhin apo me shmangien nga kompetencat e organeve gjyqësore të përcaktuara në kushtet e përgjithshme nëse ato nuk janë miratuar veçmas me shkrim. Pra në këtë këndvështrim, pretendimi se palët kanë përcaktuar në kushtet e përgjithshme zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazhin italian nuk qëndron. Gjithashtu, nga analiza që gjykata i bën nenit 64.1 të dokumentit "Kushtet e Përgjithshme" nuk rezulton që çështja objekt hetimi gjyqësor të hyjë në përcaktimet e këtij neni. Nisur nga sa më sipër, rezulton se midis palëve ndërgjyqëse nuk ka pasur një marrëveshje për caktimin e juridiksionit dhe në këtë mënyrë do të zbatohen*

dispozitat e ligjit 10428, datë 2.06.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare private" neni71...neni 80...omissis...Nisur nga sa parashikojnë dispozitat e ligjit të cituar më sipër si dhe nga fakti që kërkuesi, Shoqëria "TECNIMONT" S.p.a, nuk është më palë në këtë proces gjyqësor, rezulton se mosmarrëveshja objekt hetimi gjyqësor është një mosmarrëveshje që është plotësisht në juridiksionin e gjykatave shqiptare.(...)."

9. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur *ankim të veçantë* **i padituri Dega në Shqipëri e shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a**, me shkaqet e lartëpërmëndura.

II. Ligji i zbatueshëm:

10. Kodi i Procedurës Civile i cili parashikon që :
    - 10.1. **Neni 14 i K.Pr.Civile**: "*Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin".*
    - 10.2. **Neni 16§1 i K.Pr.Civile**:"*Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët".*
    - 10.3. **Neni 59 i K.Pr.Civile**: *" Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht , merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë".*
    - 10.4. **Neni 404 i K.Pr.Civile**: Pavlefshmëria e marrëveshjes për arbitrazh." *Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore. Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë, është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur. Marrëveshja për gjykimin me procedurë arbitrazhi shfuqizohet, kur një arbitër i caktuar sipas kësaj procedure nuk pranon misionin e besuar.*

11. Ligji nr.10428, datë 2.06.2011, "*Për të drejtën ndërkombëtare private*" i cili parashikon që:
    - 11.1. **Neni 71**: "*Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe.."*
    - 11.2. **Neni 72:** *Pavarësisht nga rregullat e këtij ligji, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e:*
      a) çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë;
      b) çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;

c) çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë;

ç) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare;

d) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë;

dh) çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë.

11.3. **Neni 80:** "*Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet e mëposhtme:*

.....

b) kur padia ka për objekt një kontratë ose pretendime që rrjedhin nga një kontratë dhe vendi, në të cilin është përmbushur ose duhej përmbushur detyrimi, ndodhet në Republikën e Shqipërisë;(...).

III.Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se:

12. Vendimi nr. ska, datë 25.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.
13. Ky Kolegj vlerëson se *ankimi i veçantë* i paraqitur nga **i padituri Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" S.p.a**, nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.Civile, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
14. Ky Kolegj çmon se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht prishjen e vendimit. Përcaktimi i saktë i juridiksionit, pra nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në ndonjë juridiksion tjetër (siç është pretendimi në rastin konkret që mosmarrëveshja duhet t'i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit), ka rëndësi të madhe për vetë fatet e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kjo është dhe arsyeja se përse Kodi i Procedurës Civile mungesën e juridiksionit gjyqësor e ka konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të normave procedurale, gjë që sjell si pasojë prishjen e vendimit nga gjykatat më të larta (neni 472, pika (b) në referencë të nenit 467).
15. Në nenin 59 të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*".
16. Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatohet se çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi. Çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor, nëse është në juridiksionin administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, nëse subjekti kërkues është një subjekt i huaj, i cili gëzon imunitet diplomatik, etj.
17. Këtë gjë gjykata mund ta bëjë *edhe kryesisht*, pra dhe pa u pretenduar nga palët dhe kjo pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ.

18. Në këto kushte, sa herë që çështja e juridiksionit bëhet objekt shqyrtimi gjyqësor, fati i procesit gjyqësor do të varet nga vendimi që merr Gjykata e Lartë në fund të shqyrtimit të kësaj çështje. Në nenin 59, pika 2 të K.Pr.Civile është parashikuar shprehimisht se: *"Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë"*.
19. Vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili pranon ekzistencën e juridiksionit gjyqësor gjatë shqyrtimit të një çështje, i hap rrugë shqyrtimit të çështjes, pa paragjykuar në asnjë rast themelin e saj. Në këto kushte *"Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin"* (neni 60, pika 2 i K.Pr.Civile).
20. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se pavarësisht se këto dispozita flasin për konfliktin midis juridiksionit administrativ dhe atë gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit të gjykatave të arbitrazhit, nga ana e gjykatës së arbitrazhit, apo nga organet gjyqësore të zakonshme.
21. Domosdoshmëria e zgjidhjes së këtij konflikti nga Gjykata e Lartë vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, *me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme.*
22. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesë të palës së paditur, Shoqëria "TECNIMONT" S.p.a, ka marrë në shqyrtim pretendimin nëse kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo duhet referuar në arbitrazh në përputhje me parashikimet e pretenduara nga kjo palë në nenin 64 të nënkontratës së sipërmarrjes të "MAIRE INGINEERING ".
23. Ky Kolegj e gjen të mbështetur konkluzionin e kësaj gjykate se çështja nuk duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas klauzolës së parashikuar në nenin 64 të nënkontratës së sipërmarrjes të "MAIRE INGINEERING" referuar shkakut dhe objektit të padisë.
24. Pala paditëse ka pretenduar mospagimin nga pala e paditur të një pjese të faturave tatimore të shitjes lidhur me zërat e punimeve të kryera të pasqyruara në këto fatura. Në nenin 2 të ligjit nr.7928, datë 27.04.1995, "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*" parashikohet se: *"Personi juridik a fizik, individ ose çdo person tjetër është person i tatueshëm nëse:*

    a) detyrohet të jetë i regjistruar në bazë të këtij ligji, apo...".
25. Nga Faturat Tatimore të Shitjes të paraqitura nga pala paditëse me cilësinë e provës rezulton se palët ndërgjyqëse që në këto fatura janë palë kontraktuese, shitës dhe blerës, janë të regjistruar si persona të tatueshëm dhe kanë numrat përkatës të identifikimi si persona të tatueshëm.
26. Në nenin 8 të po këtij ligji (TVSH) parashikohet se: *"1. Me furnizim mallrash kuptohet kalimi i së drejtës për të zotëruar si pronar pasurinë e luajtshme ose pasurinë e paluajtshme....."*. Pra sipas kuptimit të përcaktuar në këtë ligj në rastin objekt gjykimi pala paditëse pretendon se i ka shitur sipas rastit shërbimet e kryera sipas zërave të punimeve të pasqyruara në këto kontrata palës së paditur.
27. Në referim të ligjit sa sipër si dhe shkakut dhe objektit të padisë në çështjen në gjykim edhe sikur të merret e mirëqenë klauzola e arbitrazhit e parashikuar në nenin 64 të kontratës së nënsipërmarrjes (*pavarësisht pretendimit të paditësit për mosnënshtrimin e saj),* ky Kolegj vlerëson se mosmarrëveshja ndërmjet palëve nuk ka të bëjë as *me vlefshmërinë* e kontratës as me *interpretimin* e saj, të cilat mund të zgjidheshin me

klauzolë arbitrazhi, por *me detyrime monetare* të papërmbushura të pasqyruara në faturat tatimore të shitjes të nënshkruara nga palët ndërgjyqëse.

28. Kolegji merr në konsideratë në lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe parashikimet në nenin 80 të ligjit 10428, datë 02.06.2011, "*Për të drejtën ndërkombëtare private*" sipas të cilës gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar *kur padia ka për objekt një kontratë dhe vendi, në të cilën është përmbushur ose duhej përmbushur detyrimi, ndodhet në Republikën e Shqipërisë.*
29. Kolegji vlerëson të theksojë se, shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit, e cila kjo e fundit realizohet nga organet gjyqësore nëpërmjet ngritjes së padisë. Interesi i palëve për t'ja nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve arbitrazhit, bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për një zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme, në të kundërt sa rezulton në këtë gjykim kur referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse duhet të hetohet lidhur me punimet e kryera në territorin shqiptar dhe që mund e duhet të zgjidhet vetëm nga gjykata shqiptare.
30. Në analizë të sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr.s'ka, datë datë 25.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të lihet në fuqi si vendim i marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 59 dhe 485 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.s'ka, datë 25.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 04.11.2015

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S E**
Kundër		
Artan BROCI	**Admir THANZA**	**Majlinda ANDREA**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi B.A.

MENDIMI I PAKICËS

Unë, gjyqtari në pakicë, shpreh mendimin tim kundër vendimit të shumicës së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjen civile nr.11118-03130-00-2015 Regj. Themeltar, në lidhje me ankimin e veçantë e paraqitur nga pala e paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë "TECNIMONT" s.p.a.

Vendimi Nr. s'ka, datë 25.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur: "*Rrëzimi i kërkesës së palës së paditur Dega në Shqipëri e Shoqërisë*

"TECNIMONT" S.p.a, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksioni të gjykatave shqiptare...", është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural civil.

Në nenin 59 të K.Pr.Civile parashikohet se: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrative. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*".

Në nenin 37 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: "*Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj. Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë"*.

Palët kanë shprehur vullnetin e tyre për forumin kompetent të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet një veprimi juridik të vlefshëm të firmosur rregullisht prej tyre.

Marrëdhënia juridike civile që ekziston mes palëve ndërgjyqëse është krijuar nga kontrata/Urdhëri i Porosisë Nr.45000VL033, datë 21.07.2008, amenduar me Kontratën /Urdhëri i Porosisë Nr.45000VL033 01, datë 25.09.2008.

Në referim të parashikimeve të Kontratës, përkatësisht nenit 64 të **Kushteve të Përgjithshme** të Kontratës me titull Ligji i Aplikueshëm – Klauzola e Arbitrazhit- Gjykata Kompetente, është përcaktuar shprehimisht se: " *64.1 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me vlefshmërinë* ***dhe interpretimin e Dokumenteve Kontraktuale****, midis Porositësit dhe Nënkontraktuesit, Palët do të kërkojnë në radhë të parë zgjidhje miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, mosmarrëveshja do ti referohet vendimmarrjes, në bazë të nenit 806 të Kodit të Procedurës Civile, nga një panel arbitrazhi të përbërë nga tre anëtarë: i pari i emëruar nga pala propozuese me njoftim të dhënë nga zyra gjyqësore, me ftesë për palën tjetër për të vazhduar caktimin e arbitrit të saj. Pala së cilës i është drejtuar ftesa, do të njoftojë, brenda njëzet ditëve, identitetin e arbitrit të caktuar nga ajo Arbitrat, të emëruar në këtë mënyrë nga palët, procedojnë me emërimin e arbitrit të tretë...*
...Ligji i zbatueshëm do të jetë gjithmonë ligji italian.".
64. 2 "*Nëse palët kanë rënë dakort në kontratë për të përjashtuar gjykimin në Arbitrazh për kontestet që dalin nga kjo kontratë do të jetë ekskluzivisht kompetente Gjykata e Romës.*
Ligji i zbatueshëm do të jetë gjithmonë ligji italian...".

Dokumentat Kontraktuale në bazë të pikës 3 të Kontratës parashikohen të jenë: " *.....1) Porosia, e cila është dokumenti i përgatitur nga porositësi dhe i nënshkruar për pranim nga nënkontraktuesi në të cilin janë treguar, të paktën, të dhënat në vijim: objekti, çmimi i rënë dakort,* ***mënyra e faturimit dhe pagesës*** *...*".

Kushtet e Përgjithshme të kontratës janë një pjesë integrale e saj, të njohura dhe të pranuara rregullisht prej palëve kontraktore. Marrëveshja e arbitrazhit është hartuar në formën e kërkuar, ajo është pjesë e një kontrate të shkruar (*Neni 64 i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës*) të nënshkruar me vullnet të lirë prej palëve kontraktore.

Klauzola e arbitrazhit e parashikuar prej palëve, është në përputhje të plotë me parashikimet dhe Kërkesat e Konvetës së New York " *Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit*" ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr.8688, datë 20.11.2000.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë dhe interpretimin e dokumentave kontraktuale,midis porositësit dhe nënkontraktuesit. Objekt i kërkesë padisë është pagesa e faturave, për rrjedhojë në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes lidhur me pagesat dhe pretendimet e palës së paditur në lidhje me shërbimet e plotësimin e afateve kohore etj., ndaj objekt i hetimit gjyqësor do të jenë pretendimet e palëve, për ofrimin e shërbimit në përputhje kushtet kontraktore.

Në këto kushte vlerësoj se, prevalon parimi i lirisë kontraktuale që do të thotë se në kushtet kur nuk ka ndalime të posaçme, prej ligjit apo marrëveshjeve ndërkombëtare, palët janë të lira të caktojnë me marrëveshje mes tyre juridiksionin përkatës, për zgjidhjen e konflikteve mes tyre i cili mund të gjyqësor apo jashtëgjyqësor (*arbitrazh*).

Nga interpretimi i vullnetit të palëve rezulton se, palët asnjëherë nuk kanë pasur si synim që të lënë në juridiksionin e gjykatave shqiptare, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre. Kjo rezulton nga parashikimi i dispozitës nr. 64.2 të **Kushteve të Përgjithshme** të Kontratës me titull Ligji i Aplikueshëm – Klauzola e Arbitrazhit- Gjykata Kompetente, nga e cila rezulton se edhe *Nëse palët kanë rënë dakort në kontratë për të përjashtuar gjykimin në Arbitrazh për kontestet që dalin nga kjo kontratë, do të jetë ekskluzivisht kompetente Gjykata e Romës. Ligji i zbatueshëm do të jetë gjithmonë ligji italian,* duke e përjashtuar juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave shqiptare.

Për detyrimet kontraktore është parashikuar se, përcaktimi i juridiksionit mund të bëhet me vullnetin e palëve dhe kur ai është i shprehur qartësisht në kontratë bën të detyrueshëm zbatimin e atij ligji dhe juridiksioni të caktuar prej tyre.

Meqenëse palët në vullnetin e tyre, kanë përcaktuar qartësisht ligjin italian si ligjin e zbatueshëm si dhe kanë përcaktuar arbitrazhin si juridiksion kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes palëve, ***për pasojë kjo çështje nuk mund të zgjidhet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar.***

Vlerësoj të theksojë se, referuar të drejtës sonë procedurale, është e rëndësishme të kuptohet qartë që shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit, e cila kjo e fundit realizohet nga organet gjyqësore nëpërmjet ngritjes së padisë. Kjo heqje dorë e palëve kontraktuese nga juridiksioni gjyqësor, dhe dëshira për t'ia

nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin mes tyre arbitrazhit bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për zgjidhjen e problemeve të krijuara mes tyre një zgjidhje më të shpejtë, më efektive dhe më pak të kushtueshme.

Duke qenë se në rastin kur palët zgjedhin procedurën e arbitrazhit për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre, kemi në të njëjtën kohë heqje dorë nga gjykimi i mosmarrëveshjeve nga organet gjyqësore, është më se e domosdoshme që klauzola e arbitrazhit të jetë e vlefshme.

Kështu, në zbatim të nenit 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958 në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", që parashikon se: *"1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh. 3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jo operative ose e pamundur për t'u zbatuar"*, në rastin në gjykim palët kanë zgjedhur që mosmarrëveshjet e tyre të gjykohen në një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar në Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Romës, palët kanë përcaktuar edhe vendin e zhvillimit të arbitrazhit, që do të jetë Italia dhe ligji i aplikueshëm ligji italian ligj ky i cili zbatohet në vendin e zhvillimit të arbitrazhit.

Gjithashtu, në Notën Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model të një Arbitrazhi Ndërkombëtar në nenin 3 pika b (i) përcaktohet se ndodhemi përpara një arbitrazhi ndërkombëtar nëse vendi i arbitrazhit i përcaktuar me marrëveshje midis palëve ndodhet jashtë shtetit në të cilin ata kanë qendrat e biznesit, si dhe referimi i personave të të njëjtit shtet në një arbitrazh ndërkombëtar nuk pengohet as nga Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit"… palët e një mosmarrëveshje, pavarësisht faktit që mund të janë persona juridikë ose fizikë nga i njëjti shtet, mund ta referojnë çështjen e tyre në një arbitrazh ndërkombëtar në bazë të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, pavarësisht përcaktimeve të Konventës Europiane "Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar të Gjenevës", datë 21.04.1961.

Në analizë të sa më sipër, pakica shfaq mendimin se, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (shumica), duhej të vendoste:“*Nxjerrjen e çështjes objekt gjykimi jashtë juridiksionit të Gjykatave Shqiptare.”*

A N Ë T A R

Artan BROCI